



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 218/6 Prot

Tiranë, më 08.4 .2016

VENDIM

Nr. 10 ,datë 08.4 .2016

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, Ligjit Nr. 8485, datë 12.05.1999, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit, **klínika "DermoLife"** person fizik.

VËREJ SE :

Në zbatim të Urdhrit Nr.39, datë 22.02.2016 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për kryerjen e hetimit administrativ, më datë 04.03.2016 e vazhdim, është kryer hetimi administrativ, pranë kontrolluesit klinika mjekësore "DermoLife" p.f., me objekt kontrolli:

- Zbatimi nga ana e kontrolluesit klinika mjekësore "DermoLife" p.f., i Ligjit Nr.9887, datë datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar dhe akteve të miratuara nga Komisioneri gjatë kryerjes së aktivitetit të tij, në lidhje me masat për sigurinë e të dhënave personale, në zbatim të nenit 27 të ligjit.

Klinika mjekësore "DermoLife" p.f. ofron shërbime shëndetësore estetike. Gjatë aktivitetit të tij ky subjekt mbledh, përpunon, ruan etj., të dhëna personale të punonjësve dhe subjekteve të të dhënave "pacientë". Referuar nenit 3 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", ky subjekt është në kushtet e Kontrolluesit.

Nga hetimi administrativ i kryer pranë këtij kontrolluesi grupi i inspektimit ka konstatuar:

1. Kontrolluesi nuk e ka plotësuar detyrimin për "Njoftim", verifikuar nga regjistri elektronik i kontrolluesve të cilët kanë njoftuar pranë zyrës së K.D.I.M.D.P., në zbatim të nenit 21 dhe 22 të ligjit;
2. Kontrolluesi publikon fotografi të pacientëve në portalin zyrtar dhe facebook: <http://www.dermolife.al>. Grupi i kontrollit konstatoi se kontrolluesi merr pëlqimin me shkrim

të subjektit të të dhënave por nuk informon subjektet e të dhënave, në lidhje me të drejtën për akses në të dhënat personale, të drejtën për të kërkuar bllokimin, korrigjimin apo fshirjen e tyre.

3. Kontrolluesi nuk ka një rregullore në lidhje me mbledhjen, përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave personale;
4. Kontrolluesi nuk aplikon deklaratën e konfidencialitetit me punëmarrësit
5. Kontrolluesi ka vendosur një sistem video-vëzhgimi CCTV, nëpërmjet të cilit mbikëqyr ambientet e brendshme duke përfshirë edhe dhomat e masazhit apo të veprimeve/ndërhyrjeve estetike intime.
6. Kontrolluesi nuk aplikon aneks kontratën tip në rastin e delegimit të përpunimit të analizave shëndetësore me palë të treta sipas Udhëzimit Nr.19 të Komisionerit "*Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi*".

Përshkrimi i gjetjeve administrative.

- 1- Kontrolluesi "*DermoLife*" p.f., nuk e ka realizuar "*Njoftimin*" në lidhje me përpunimin e të dhënave pranë zyrës së K.D.I.M.D.P.-së, në shkelje të neneve 21 dhe 22 të ligjit nr. 9887/2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" i ndryshuar;
- 2- Kontrolluesi nuk informon subjektet e të dhënave në lidhje me të drejtën për akses në të dhënat personale, të drejtën për të kërkuar bllokimin, korrigjimin apo fshirjen e tyre, në shkelje të neneve 12 dhe 18 të ligjit nr. 9887/2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" i ndryshuar;
- 3- Kontrolluesi nuk ka një rregullore në lidhje me mbledhjen, përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave personale, në shkelje të nenit 27 të ligjit nr. 9887/2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" i ndryshuar;
- 4- Kontrolluesi nuk aplikon deklaratën e konfidencialitetit me punëmarrësit, në shkelje të nenit 18 të ligjit nr. 9887/2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" i ndryshuar;
- 5- Kontrolluesi ka vendosur një sistem video-vëzhgimi CCTV nëpërmjet të cilit mbikëqyr ambientet e brendshme duke përfshirë edhe dhomat e masazhit apo të veprimeve/ndërhyrjeve intime, në shkelje të nenit 5, gërma "c" të ligjit nr. 9887/2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" i ndryshuar;
- 6- Kontrolluesi nuk aplikon aneks kontratën tip në rastin e delegimit të përpunimit të analizave shëndetësore me palë të treta sipas Udhëzimit Nr.19 të Komisionerit "*Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi*".

Në përfundim të hetimit administrativ pasi u mbajt procesverbali për konstatimet e gjetura nga ana e grupit të hetimit, përfaqësuesja e kontrolluesit parashtroi pretendimin: "*Nuk kam pasur dijeni për ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale megjithatë ne do të rikuperojmë sa më shpejtë të jetë e mundur shkeljet e konstatuara*".

Në zbatim të neneve 93-96 të Ligjit Nr.8485, datë 12.05.1999, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, për respektim të së drejtës për t'u dëgjuar, në datë 05.04.2016, përpara marrjes së vendimit përfundimtar është organizuar seanca dëgjimore me përfaqësuesin e kontrolluesit, i cili kishte rikuperuar pjesërisht shkeljet e konstatuara, në lidhje me gjetjet e grupit të inspektimit administrativ.

Konstatimet e gjetura konsiderohen në shkelje dhe mosrespektim të kushteve dhe kriterëve që parashikon Ligji Nr.9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, por mbikëqyrja në ambientet ku kryhet masazhi dhe ambientet e ndërhyrjeve intime estetike, përbën një shkelje flagrante dhe serioze.

Zyra e Komisionerit duke parë serioze shkeljet e konstatuara, ka dalë me Urdhërin Nr.89, datë 06.04.2016 pasi fakti që, kontrolluesi ka marrë masat duke hequr kamerat vëzhguese nga këto ambiente, ishte i pamjaftueshëm. Ky urdhër konsiston në shkatërrimin e menjëhershëm të të dhënave personale të siguruar në mënyrë jo të drejtë dhe haptazi të paligjshme, nëpërmjet sistemit video-vëzhgimi CCTV, i cili mbikëqyr ambientet e brendshme, ku kryhet masazhi dhe ambientet e ndërhyrjeve intime estetike.

Si përfundim, shkeljet e konstatuara gjatë hetimit administrativ në kuptim të nenit 39/1 gërmat "a", "d" dhe "dh" të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe sanksionohen me gjobë, si më poshtë:

a) kontrolluesit, që përdorin të dhëna personale në kundërshtim me kreun II "Përpunimi i veçantë i të dhënave personale", dënohen, me 10 000 deri në 500 000 lekë;

d) kontrolluesit që nuk përmbushin detyrimin për të njoftuar, sipas përcaktimit në nenin 21 të këtij ligji, dënohen me gjobë në vlerën 10 000 deri në 300 000 lekë.

dh) kontrolluesit ose përpunuesit, që nuk marrin masat e sigurisë së të dhënave dhe nuk zbatojnë detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit, të përcaktuara përkatësisht në nenet 27 dhe 28 të këtij ligji, dënohen me nga 10 000 deri në 500 000 lekë.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, zyra e Komisionerit ka parasysh faktin se shkeljet e konstatuara janë serioze, ato lidhen me sigurinë e të dhënave personale, detyrimin për informim, si një e drejtë parësore në zbatim të ligjit dhe parimeve bazë të mbrojtjes së të dhënave personale.

Komisioneri gjithashtu, ka parasysh faktin që kontrolluesi ka qënë në bashkëpunim serioz me grupin e kontrollit gjatë ushtrimit të hetimit administrativ dhe ka reaguar në rikuperimin e tyre.

PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve 5, 21, 27, 28, 30, 31, 39/1, gërmat "a", "d" dhe "dh", si dhe neneve 40 dhe 41 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar,

V E N D O S A :

1. Dënimin e kontrolluesit, klinika "DermoLife" p.f., me gjobë, në vlerën **100 000 (njëqind mijë) lekë** për shkelje të përcaktuar në kreun II, neni 5 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.
2. Dënimin e kontrolluesit, klinika "DermoLife" p.f., me gjobë, në vlerën **50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë** për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 21 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.
3. Dënimin e kontrolluesit, klinika "DermoLife" p.f., me gjobë, në vlerën **30 000 (tridhjetë mijë) lekë** për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenet 27 dhe 28 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.
4. Kontrolluesi, klinika "DermoLife" p.f., domosdoshmërisht të realizojë aneks kontratën tip të konfidencialitetit, sipas Udhëzimit Nr.19, të Komisionerit, për përpunimin e të dhënave personale nga palë të treta (pëpunuesë), të cilët i pajton për kryerjen e shërbimeve që ata ofrojnë, e për pasojë aksesojnë të dhëna të pacientëve të kontrolluesit.
5. Kontrolluesi klinika "DermoLife" p.f., të rikuperojë shkeljet e konstatuara nga grupi i kontrollit brenda një periudhe prej 30 ditësh.
6. Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij vendimi. Me kalimin e afatit të ankimit, ky vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga zyra e përmbarimit.
7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij vendimi.

Ky vendim u shpall sot në, 08.4 .2016

